

VENDIM
Nr.130, datë 13.10.2011

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA DHE EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT
DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 114 dhe 116 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Ibsen Elezi lirohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- II. Zoti Alban Karapici zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)